



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIA REGIONALNI VODOVOD D.O.
Rruga e Liqenit p.n. - 40000 Mitrovicë
26-09.23 1395

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe vendimin e Bordit të Drejtorëve Kompania Rajonale Ujësjiellësi „Mitrovica,, Sh.A. shpall:

KONKURS PËR PUNË PRAKTIKE

Kohëzgjatja e angazhimit: 6 muaj me mundësi vazhdimi

Pozita të lira shtatë (7);

Vendi punës: Kompania Rajonale Ujësjiellësi „Mitrovica,, Sh.A: dy (2) në Mitrovicë, tre (3) Nj. Vushtrri dhe dy (2) Nj. Skënderaj

Orari i punës: Me kohë të plotë: (5 ditë në javë);

Vërejtje: Puna praktike nuk do të thotë punësim.

I. Emërtimi i vendit te punës: Praktikant

Përgatitja profesionale: Student apo i diplomuar në drejtimin Teknik (Gjeodezi, Hidroinxhinieri ose fusha të ngjashme)

Vendi punës: Kompania Rajonale Ujësjiellësi „Mitrovica,, Sh.A në Nj. Mitrovicë

Numri i kryerësve: (2)

Koeficienti i pagës: 264 Euro (bruto)

Aftësitë e buta: aftësitë e mira të komunikimit, njohuri në programet kompjuterike (Word, Excel)

Përshkrimi i detyrave: Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të mbikëqyrësit përgjegjës nga kompania , praktikanti do të:

- Të asistoj në vendosjen e të dhënave për projektet e përfunduara;
- Asiston në digjitalizimin e të dhënave në sistemin e GIS&EDAMS për të gjitha astetet teknike
- Mbështet institucionin në aktivitetet e përditshme në Departamentin Teknik.
- Kryen edhe punë të tjera sipas rekomandimit të Udhëheqësit.

II. Emërtimi i vendit te punës: Praktikant

Përgatitja profesionale: Student apo i diplomuar në drejtimin Komunikim Masiv, Administrim Biznesi, Marketing, Menaxhimi i Mbrojtjes se Mjedisit.

Vendi punës: Kompania Rajonale Ujësjiellësi „Mitrovica,, Sh.A -

Numri i kryerësve: (5) - tre (3) Nj. Vushtrri dhe dy (2) Nj. Skenderaj

Koeficienti i pagës: 264 Euro (bruto)

Aftësitë e buta: aftësitë e mira të komunikimit, njohuri në programet kompjuterike (Word, Excel)

Përshkrimi i detyrave: Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të mbikëqyrësit përgjegjës nga kompania , praktikanti do të:

- Mbështes në përmbushjen e afateve ligjore dhe rregullative me kontratat të shërbimit me konsumator;
- Bënë përditësim të dhënave të konsumatorëve;
- Mbështes institucionin në aktivitetet e përditshme në Departamentin Komercial.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Dokumentet e më poshtme dërgohen përmes emailit burimet.njerezore@kru-mitrovica.com

- CV-në;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatën e notave ose diploma e noterizuar;
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj.

Afati i aplikimit do të jetë i hapur 15 ditë nga data **26.09.2023** deri më **10.10.2023**.

Dokumentet e pranuar pas afatit të paraparë nuk pranohen kurse ato të mangëta refuzohen.

Praktikantët në përfundim të programit të punës do të pajisen me Vërtetim nga Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A.

Inkurajohen të aplikojnë të gjithë studentët apo të diplomuarit pa kurrfarë diskriminimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

